



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News:

Delvinë/Procedohen penalisht 4 shtetas që shpërdoruan detyrën duke hedhur mbetje spitalore në ambiente të papërshtatshme, në kundërshtim me ligjin Berat – Siguronin cannabis sativa, me qëllim ndarjen dhe shitjen në doza, në lagje të ndryshme të qytetit, arrestohet 1 shtetas, procedohet penalisht 1 tjetër DVP Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Goldish Axe” Policia e Shtetit – Finalizohet si rezultat i shkëmbimit të informacioneve mes Interpol Tiranës dhe Interpol Mançester, Mbretëri e Bashkuar, operacioni policor i përbashkët, i koduar “Capital” Interpol Tirana – Ekstradohet nga Shqipëria në Itali, 30-vjeçari që akuzohet se organizoi në dhjetor të vitit 2022, në Itali, vrasjen me mjet prerës, të bashkëshortit të motrës së tij



LajmetOperacionet

18/01/2024

Berat – Siguronin Cannabis Sativa, Me Qëllim Ndarjen Dhe Shitjen Në Doza, Në Lagje Të Ndryshme Të Qytetit, Arrestohet 1 Shtetas, Procedohet Penalisht 1 Tjetër

Berat/Kontrolle të mbështetura te inteligjenca policore dhe hetime proaktive, po kryhen në kuadër të megaoperacionit antidrogë “Tempulli”.

Siguronin cannabis sativa, me qëllim ndarjen dhe shitjen në doza, në lagje të ndryshme të qytetit, arrestohet një 39-vjeçar dhe procedohet penalisht një 40-vjeçar.

Në banesën e të arrestuarit u gjet një sasi lënde narkotike cannabis sativa, ndërsa në banesën e të proceduarit u gjetën disa fishekë arme gjahu.

Si rezultat i një hetimi të ndjekur proaktivisht, në kuadër të megaoperacionit policor “Tempulli” dhe në bashkëpunim me Prokurorinë e Beratit, për të nxjerrë përpara përgjegjësisë penale, shtetasit përgjegjës për një tjetër rast të veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve, specialistët për Hetimin e Narkotikëve të DVP Berat vunë në pranga shtetasin E. K., 39 vjeç, si dhe referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin R. K., 40 vjeç, të dy banues në Roskovec.

Nga hetimet rezultoi se këta shtetas bashkëpunonin për të siguruar sasi të lëndës narkotike cannabis sativa, e cila më pas ndahej në doza, me qëllim shitjen në lagje të ndryshme të qytetit të Beratit.

Nga kontrollet në banesën e 39-vjeçarit u gjet një sasi lënde narkotike cannabis sativa, ndërsa në banesën e 40-vjeçarit u gjetën 5 fishekë arme gjahu. Lënda narkotike dhe municioni luftarak u sekuestruan nga shërbimet e Policisë, në cilësinë e provës materiale.

Vijojnë hetimet për të identifikuar shtetasit e tjerë të përfshirë në këtë veprimtari.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprime të mëtejshme.

angazhimpërkushtimsakrificë👮🚓

tëvendosurkundërkrimit✅

nëçdoskajtëvendit🇦🇱

nëshërbimtëqytetarëve👮🤝👤



◀ DVP Tiranë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Goldish Axe”

Delvinë/Procedohen penalisht 4 shtetas që shpërdoruan detyrën duke hedhur mbetje spitalore në ambiente të papërshtatshme, në kundërshtim me ligjin ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)